

PENDINOVA

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



GHS 07

GHS 08

GHS 09

RREZIK

"Lexo fletëudhëzuesin përpara përdorimit"

Herbicidi për kontrollin e barërave të këqia gjethegjëra dhe graminore një vjeçare.

Përmbajtja: *Pendimethalin 330 gr/l.*

Formulimi: *Koncentrat i emulsionueshëm (EC).*

Masat parambrojtëse:

P280- Vishni doreza mbrojtëse/veshje mbrojtëse/Mbroni sytë/fytyrën.

P301+P310+P331 NË RAST GËLLTITJE: Kontaktoni menjëher një qëndër anti helmimi ose një mjek. MOS provoko të vjella.

P302+P352- NË RAST KONTAKTIMIT ME LËKURËN- Lani atë me ujë të bollëshëm dhe sapun. P305+P351+P338 NË RAST KONTAKTI ME SYTË: shplani ato me kujdes për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit në se mundeni dhe vazhdoni shpëlarejn.

P304+P340- NË RAST INHALIMI- Transportoni personin e dëmtuar në ajër të hapur duke e vendosur atë në një pozicion që favorizon frymëmarrje normale.

P391- Mblidhni materialin e derdhur.

P501- Asgjësoni produktin/enën në përputhje me rregullat kombëtare.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

H302- I dëmshëm nëse gëlltitet.

H304- Mund të jetë vdekjeprurëse në rast të gëlltimit dhe depërtimit në traktin respirator.

H315- Shkakton acarim të lëkurës.

H319 – Provokon iritim të rëndë në sy.

Në rast helmimi nga goja drejtoheni mjekut dhe i tregoni atij etiketën. Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simbas simptomave. Në rast përzierje me produkte të tjera, informo mjekun për përzierjen që ke përdorur.

Përdorimi:

PENDINOVA vepron duke frenuar mbirjen e farave ose zhvillimin e bimzave të porsambira të barërave mono dhe dykotiledone. Kontrollon gjithashtu edhe barërat e keqia të porsambira kur ato janë në fazën e 1-1.5 gjetheve të vërteta për gjethegushtat (monokotiledone) dhe 2-3 gjethe për gjethegjërat (dikotiledone).

Gjethegushta graminore njëvjeçare (monokotiledone) *Alopecurus myosuroides* (Bisht dhelpra), *Digitaria sanguinalis* (Meli i kuq), *Echinochloa crus-galli* (kostreva), *Panicum dichotomiflorum* (Meli amerikan), *Setaria viridis* (Kostreva), *Sorghum halepense* (Sorgumi).

Gjethegjëra një vjeçare *Amaranthus retroflexus* (Nena), *Anagallis arvensis* (ruthe e fushave) *Atriplex spp.* (laboti), *Capsella bursa-pastoris* (Trasta e bariut), *Cardamine hirsuta* (kardamina), *Chenopodium album* (Minueri i bardhë), *Cerastium arvense* (qerasti), *Euphorbia helioscopia* (ryelli), *Fumaria officinalis* (fumaria), *Heliotropium europaeum* (diell dridhesi), *Lamium spp.* (hithbuta), *Mercurialis annua* (barthelleza), *Myosotis arvensis* (luemiza), *Papaver rhoeas* (Lulkuqi), *Polygonum persicaria* (Nejca ghetepjeshke), *Portulaca oleracea* (Burdullaku), *Ranunculus repens* (zhabina), *Stellaria media* (Yllezi i pyllit), *Solanum nigrum* (hidhnaku i zi), *Sonchus arvensis* (reshyelli), *Spergula arvensis* (sprgularia), *Stachys annua* (sarusha), *Thlaspi arvense* (Thlaspi arave). *Urtica urens* (hithra), *Veronica spp.* (veronika) e *Viola spp.* (manushaqi e fushave).

Hudhër: 3-4 lit/ha para mbirjes ose pas mbirjes së kutures, në 2 gjethe të vërteta; **Presh:** Në mbjellje me fidan 4 lit/ha para trapjantimit ose pas trapjantimit pas 3 gjetheve të vërteta. **Qepë:** Në mbjellje me bulba pas mbjelljes-para mbirjes me 2-3 lit/ha, në mbjellje me fidan 2-3 lit/ha para trapjantimit ose pas 3 gjetheve të vërteta.

Asparagu: 3-4 lit/ha para çeljes së sythave; **Angjinat:** 3-4 lit/ha para trapjantimit; **Karota:** 3-4 lit/ha para mbirjes dhe 3-4 lit/ha pas mbirjes në 3-4 gjethe; **Laker:** 2-2.5 lit/ha para trapjantimit. **Qiqra:** Perpara mbirjes 2 lit/ha ne terene te lehta dhe 2 lit/ha ne terene te renda; **Fasule, Bathë:** 2 lit./ha pas mbjelljes para mbirjes ne toka te lehta, 2.5 lit/ha ne toka argjilore.

Kikirik: 3-4 lit/ha para mbirjes; **Finoku:** 2-2.5 lit/ha para mbirjes ose para trapjantimit (jo ne terene ranore) **Luledielli:** 3-4 lit/ha pas mbjelljes para mbirjes; **Grurë, Theker, Sorgum:** 2-3 lit/ha pas mbjelljes para mbirjes dhe pas mbirjes me 3 gjethe 3-4 lit/ha; **Sallata, Endivia:** 2.2.5lit./ha para trapjantimit; **Misë:** 3-4 lit./ha pas mbjelljes para mbirjes dhe pas mbirjes 3lit/ha ne 2 gjethe; **Patlloxhan:** 3 lit/ha para trapjantimit; **Ornamentale:** në fidanishte 3-4 lit/ha para dhe pas trapjantimit; **Patate:** 3-4 lit/ha pas mbjelljes para mbirjes. **Specat:** 2-3 lit/ha pas mbjelljes para mbirjes. **Mollë, Dardhë Pjeshkë, Nektarina, Kajsi, Vreshta:** 3-4 lit/ha në periudhen e qetësisë vegjetative para fryrjes së sythave nuk perdoret ne toka te lehta; **Plepa:** 2-3 lit/ha pas trapjantimit; **Agrume:** 3-4 lit/ha në pranverë ose në vjeshtë para fillimi të vegjetacionit të ri, nuk perdoret ne toka te lehta.

Bizele: 3-4 lit/ha pas mbjelljes para mbirjes, dozat me te larta ne mbjelljet e vjeshte; **Domate:** 2-2.5 lit/ha para trapjantimit; **Sojë:** 2.5-3.5 lit/ha pas mbjelljes para mbirjes; **Duhan:** 1.5-2.5 lit/ha ne toke te lehte dhe 3-4 lit ne teren argjiloz para trapjantimit; **Tapet bari:** 3 lit/ha pas mbirjes;

Ne te gjitha kulturat: Dozat me te larta perdoren ne toka me te renda. Sasia e ujit te perdorur eshte 200-600 lit/ha duke pasur kujdes qe te shmangim mbi kalimet dy here ne te njejten siperfaqe.

Vërejtje për përdorimin:

Ne kulturat e mbjella me fare ose zhardhoke trajtimi nuk duhet te vonohet me shume 2 dite pas mbjelljes. Megjithëse pordukti atakon farërat në mbirje apo bimzat e porsa mbira, ai nuk duhet të perdoret me inkorporim (me depërtim në shtresën siperfaqësore) Gjatë përdorimit në kulturat pranverore, nëse nuk bien shira për një periudhë 7-10 ditë nevojitet të kryhet një uitje për të garantuar kontaktin me farën apo të porsambirat. Toka duhet te jete e pregatitur mire dhe uniforme. Ne rastet e përdorimit ne kultura te mbjella me fare, duhet te bejme kujdes qe fara te mbillet ne thellesi deri 3 cm per *karrten*, *qepen* dhe 4 cm per kulturat e tjera. Na kulurat me trapjantim toka pregatite paraprakisht, shperndahet produkti me uje me nje ujitje te lehte, lihet per nje periudhe 7-8 dite nga trapjantimi. Pas trapjantimit kryejm perseri nje ujitje te lehte. *Nuk duhet te behet mbathje e kutures pa kaluar 30 dite nga trajtimi.* **Përzierje me produkte të tjera:** Pendinova nuk rekomandohet të përdoret në përzierje me formulime të tjera. **Kujdes:** Nëse në një siperfaqe të mbjellë me farë dhe trajtuar me Pendinova, ku për arsye të ndryshme kërkohet të bëhet rimbjellje me fare e kultures ose kulture tjeter nje gje e tille nuk duhet te behet pa kaluar te pakten 6 muaj nga trajtimi. Perkundrazi asnje rrezik nuk do te kete nese ate siperfaqe e mbjellim duke trapjantuar fidane te ndryshem.

Pregatitja e solucionit sperkates: Hedhim gjysem e sasisë së ujit në depozitën e mjetit spërkatës; vendosim përzierësin në punë dhe hedhim sasinë e duhur të produktit; me pas hedhim gjysmen tjeter te ujit duke mbajtur përziersin në punë të vazhdueshme. **Larja e mjeteve të punes:** Në përfundim të trajtimit lani me shumë kujdes paisjet për të eliminuar çdo mbetje të preparatit. Mbushni depozitën me uje te paster dhe zbrazeni për të shplarë pompën dhe tubacionet duke e përsëritur dy herë. Mbushni përsëri depozitën me ujë të pastër dhe shtoni një detergjent shplarës. Shplajeni tërësisht pompen dhe tubat duke mbajtur përzierësin në funksion për 10 minuta dhe zbrazeni përsëri. Mbusheni depozitën me ujë të pastër dhe zbrazeni përsëri nëpermjet pompës dhe tubave për të larguar cdo gjurmë të detergjenteve. Filtrat duhet të hiqen e të pastrohen më vehte me solucion hipoklorit natriumi. **Kujdes:** Kryhet vetëm një trajtim për një cikël vegjetativ (për të gjitha kulturat). Dozat më të larta përdoren në toka të rënda dhe të pasura me lëndë organike, ndërsa përdoren doza më të ulëta në toka të lehta.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik në se përdoret sipas rekomandimeve të kësaj etikete. Por në rastet kur kulturat janë në fazën e shperthimit të sythave apo pjesëve të tjera delikate si në angjinare e bimë dekorative duhet të shmangim kontaktet e produktit me bimët.

Ndikimi ne mjedis:

Për të mbrojtur organizmat ujorë afër parces qe do te trajtohet respektoni një brez sigurie të pa trajtuar me gjerësi prej 10 metrash nga siperfaqia ujore, nese ka nje te tille. Për mbrojtjen e kulturave te tjera prane parces qe trajtohet, duhet te respektohet nje brez i pa trajtuar me gjerësi te pakten prej 20 metra nga parcela tjetër. Mos ndotni ujin me produktin ose enën e tij. Mos pastroni mjetet e aplikimit afër ujerave sipërfaqësore. Shmangni ndotjen përmes ujrave rjedhëse në rrugët e fermave. Gjatë fazave të përgatitjes dhe përzierjes së produktit vishni doreza, veshje mbrojtëse dhe mbrojtje personale për fytyrën/sytë. Mos

hyni sërish në zonën e trajtuar përpara se bimësia të jetë plotësisht e tharë nga solucioni spërkatës. Në rast hyrje në parcelën e trajtuar menjëherë pas spërkatjes duhet të keni veshur roba mbrojtëse. Është helmues për peshqit. Mos ndotni ujrat e rjedhëshme, kanalet dhe basenet me tretësirën spërkatëse ose ambalazhet.

Karenca:

Trajtimi fundit para vjeljes: 28 ditë për asparagus, 75 ditë për sallatën dhe 140 ditë për karotën.

Kujdesi produkti mund të jetë fitotoksik në kulturat pasardhëse të cilat mbillen më fare, prandaj duhet të respektohen këto periudha pritëshmerie para mbjelljes:

Kultura	Priteshmeria
Bime me frut renjor ose zhardhok	190 ditë
Panxhar	300 ditë
Perime bulbore	200 ditë
Perime gjethore	200 ditë
Drithra	200 ditë

Kushtet e ruajtjes dhe magazinimi:

Produkti ruhet në ambalazhe origjinale, i pa ekspozuar ndaj rezeve direkte të diellit dhe në një temperaturë 0-45⁰ C.

Nr dhe data e regjistrimit: 753, datë 4.12.2020.

Numrin e serisë ose shenja të tjera identifikuese: _____;

Data e prodhimit: _____;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara) : 3 vjet;

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin bazë: 500 ml, 1000 ml, 5 lit. Tipi i ambalazhit bazë: shishe HDPE ose COEX.

Emri dhe adresa e aplikantit: Finchimica S.p.A. **Adresa:** Manerbio (BS) Itali.

Emri dhe adresa e prodhuesit: 1. Finchimica S.p.A. **Adresa:** Manerbio (BS) Itali.;

2. SPACHEM S.L. **Adresa:** Pol. Ind. Guadasequies, 46839 Guadasequies, Valencia, ES Contact person: Mr. Pablo Martí Monfort Telephone: +34 962 29 30 93 Email: pmarti@spachem.es